

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA SUHAREKË**
(Shëno emrin e Autoritetit Kontraktues)

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **624-26-2748-5-2-1**
(Shëno numrin e Aktivitetit të Prokurimit)

Sa i përket tenderit për: **Ndertimi i salles sportive ne Peqan**
(Shëno titullin e kontratës si në Dosjen e Tenderit)

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

“AAB CONSTRUCTION” SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Luan Haradinaj soll HY 1 nr. 4

(Adresa)

Prishtinë

(Vendi)

10000

(Kodi postar)

044 281 360

(Numri Telefonit)

1

(Numri i Faks-it)

Arlind Buzhala

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

constructionaab@gmail.com

(Adresa elektronike)

22.05.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.


(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Publikimi i B05 – Njoftimit për Kontratë, më datë **29.04.2026**
- Vendimi për pezullim ndaj operatorit ekonomik DK Construction SH.P.K., më datë **08.05.2026**
- Parashtrimi i kërkesës për rishqyrtim nga Kompania jonë, më datë **09.05.2026**
- Vendimi për pezullim ndaj operatorit ekonomik AAB Construction SH.P.K., më datë **12.05.2026**
- Vendimi për refuzim ndaj operatorit ekonomik AAB Construction SH.P.K.: **14.05.2026**
- Vendimi për aprovim pjesërisht ndaj operatorit ekonomik DK Construction SH.P.K., më datë 14.05.2026
- Publikimi i Formularit Standard B54 për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara, më datë 14.05.2026
- Vendimi për pezullim ndaj operatorit ekonomik 3D PROCON SH.P.K., më datë 15.05.2026
- Vendimi për pezullim ndaj operatorit ekonomik NNP CTA SH.P.K., më datë 15.05.2026
- Vendimi për pezullim ndaj operatorit ekonomik AI GROUP SH.P.K., më datë 15.05.2026
- Vendimi për refuzim ndaj operatorit ekonomik 3D PROCON SH.P.K., më datë 18.05.2026
- Vendimi për refuzim ndaj operatorit ekonomik NNP CTA SH.P.K., më datë 18.05.2026
- Vendimi për refuzim ndaj operatorit ekonomik AL GROUP SH.P.K., më datë 18.05.2026
- Publikimi përsëri i Formularit Standard B54 për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara, më datë 19.05.2026.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Procedura është ende në fazën tenderuese.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Pasi kemi shqyrtuar Njoftimin për Kontratë, të datës 29.04.2026, dhe kemi analizuar kriteret e vendosura, të cilat vlerësojmë se nuk janë në përputhje të plotë me natyrën e kontratës, kemi ndërmarrë veprimet si në vijim:

- Më datë 09.05.2026 është parashtruar Kërkesa për Rishqyrtim nga kompania jonë;
- Më datë 12.05.2026 është nxjerrë Vendimi për pezullim ndaj operatorit ekonomik AAB Construction SH.P.K.;
- Më datë 14.05.2026 është nxjerrë Vendimi për refuzim të kërkesës së operatorit ekonomik AAB Construction SH.P.K.

Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e lartcekura dhe zhvillimet procedurale, konsiderojmë se janë cenuar të drejtat tona si palë e intereit për këtë procedurë të tenderimit, dhe si rrjedhojë jemi të detyruar të ushtrojmë të drejtën tonë ligjore përmes paraqitjes së kësaj ankese.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e LPP-se nga ana e AK-së:

Neni 1 Qëllimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 52 Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës

Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës.

Neni 65 Provueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Gjithashtu AK ka shkelur edhe dispozitat përkatëse të RrUOPP-se.

** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar, ne si palë e interesit për këtë procedurë, kemi analizuar Njoftimin për Kontratë të datës 29.04.2026 dhe brenda afatit ligjor, konform nenit 108/A–Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, ne afatin ligjor konform ligjit, ushtrojmë këtë:

ANKESË

Autoriteti Kontraktues në Dosjen e tenderit dhe Njoftimin për kontratë ka paqitur kriteret si në vijim: Në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2–Kërkesa3, është kërkuar që të ofrohet:

- **Prendimi 1: Kërkesa 3-Operatori Ekonomik duhet të propozojë një Udhëheqës të Punishtes, i cili duhet të përmbushë këto kërkesa minimale •Të jetë Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë–me specializim Menaxhimi i Ndërtimtarisë dhe Teknologji; •Të ketë përvojë pune profesionale prej së paku 5 (pesë)vite pas diplomimit; •Të jetë i pajisur me licencë valide të kategorisë A, të lëshuar nga organi kompetent.**

Nga analiza e listës së inxhinierëve të licencuar me licencën përkatëse, rezulton qartë se vetëm dy(2)inxhinierë në nivel vendi e plotësojnë kriterin e vendosur nga Autoriteti Kontraktues, i cili kërkon Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë specializimin“Menaxhimi i Ndërtimtarisë dhe Teknologji”.Ky fakt dëshmon se kriteri nuk ka karakter të përgjithshëm dhe të hapur për konkurrencë të gjerë, por në mënyrë të drejtpërdrejtë kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, duke krijuar pabarazi dhe diskriminim në pjesëmarrje të tenderit.. Për më tepër, një kriter i tillë nuk është i domosdoshëm për natyrën e këtij projekti, pasi objekt i kontratës nuk lidhet me kërkesa specifike teknologjike që do ta justifikonin këtë specializim të veçantë. Edhe pse Autoriteti Kontraktues në përgjigjen e tij pretendon se kriteri“nuk përmban emër personi apo kompani të caktuar” dhe se është “i përgjithshëm dhe proporcional”, një pretendim i tillë bie ndesh me realitetin faktik të tregut i cili mund të verifikohet edhe në listën e inxhinierëve të licencuar, ku ekzistojnë vetëm dy persona të licencuar me këtë specializim në të gjithë vendin.Kjo e bën kriterin kufizues dhe jo konkurrues,pavarësisht formulimit të tij formal. Përkundrazi, përfshirja e këtij kriteri në kushtet kur ekziston një numër kaq i kufizuar i profesionistëve të licencuar,e dëshmon karakterin e tij diskriminues dhe kufizues për konkurrencën e hapur. Duke marrë parasysh edhe faktin se operatorë të tjerë ekonomikë kanë parashtruar kërkesa të ngjashme për rishqyrtim në këtë procedurë të tenderimit, përforcohet edhe më tej pretendimi se ky kriter cenon parimet themelore të prokurimit publik, përkatësisht barazinë në trajtim dhe konkurrencën e lirë.

Andaj, kërkojmë nga ana juaj që pretendimi ynë të merret i bazuar dhe të obligohet AK të largojë këtë kriter diskriminues nga dosja e tenderit, duke mundësuar pjesëmarrje të barabartë dhe konkurrencë reale ndërmjet operatorëve ekonomikë.

• **Prendimi 2: Në Kërkesën 12 është kërkuar si në vijim: Së paku dy(2) punëtorë me përvojë dhe certifikim në punime me gips(gips-karton);**

Sa i përket kërkesës për së paku dy (2) punëtorë me përvojë dhe certifikim në punime me gips (gips-karton), konsiderojmë se AK nuk ka arritur të argumentojë në mënyrë konkrete dhe proporcionale domosdoshmërinë e këtij kriteri. Në përgjigjen e dhënë janë paraqitur vetëm arsyetime të përgjithshme lidhur me rëndësinë e cilësisë së punimeve me gips-karton, mirëpo nuk është dëshmuar se në paramasë dhe parallogari ekziston volum apo kompleksitet i tillë i punimeve që arsyeton kërkesën për dy punëtorë të certifikuar posaçërisht për këtë kategori. Punimet me gips-karton janë punime standarde ndërtimore që në praktikë realizohen nga ekipe të zakonshme ndërtimore me përvojë adekuate profesionale, pa qenë e nevojshme posedimi i certifikimeve specifike individuale. AK nuk ka paraqitur asnjë bazë ligjore apo standard teknik që e bën certifikimin kusht të domosdoshëm për realizimin e këtyre punimeve. Për më tepër, kërkesa për dy punëtorë të certifikuar paraqet kriter joproporcional dhe kufizues për konkurrencën, pasi tejkalon nevojat reale të projektit dhe krijon barriera të panevojshme për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik. Andaj, kërkojmë nga ana juaj që pretendimi ynë të merret i bazuar dhe të obligohet AK të largojë këtë kriter diskriminues nga dosja e tenderit, duke mundësuar pjesëmarrje të barabartë dhe konkurrencë reale ndërmjet operatorëve ekonomikë.

• **Prendimi 3: Në Kërkesën 12 është kërkuar si në vijim: Së paku një (1) punëtor me përvojë dhe certifikim në prodhimin dhe montimin e deryve dhe dritareve;**

Sa i përket kërkesës për së paku një(1)punëtor me përvojë dhe certifikim në prodhimin dhe montimin e deryve dhe dritareve, konsiderojmë se kjo kërkesë nuk është në përputhje me objektin real të kontratës. Në paramasë dhe parallogari nuk janë të parapara aktivitete prodhuese të deryve dhe dritareve, por vetëm furnizimi dhe montimi i tyre në kuadër të punimeve ndërtimore. Prodhimi paraqet veprimtari të veçantë industriale dhe nuk mund të kërkohej si kriter profesional në një kontratë ku objekti kryesor nuk është prodhimi. Edhe vet AK në përgjigjen e tij sqaron se kërkesa nuk duhet të interpretohet si detyrim që OE të jetë prodhues industrial, mirëpo përkundër kësaj kriteri vazhdon të përmbajë termin “prodhim” duke krijuar paqartësi dhe kufizim të panevojshëm të konkurrencës. Tutje në përgjigjen e ofruar fillon duke treguar se qfarë funksioni kryejnë dyert dhe dritaret.Për këtë arsye, kriteri është i paarsyeshëm, joproporcional dhe diskriminues ndaj operatorëve ekonomik që kanë kapacitet të plotë për realizimin e kontratës. Andaj, kërkojmë nga ana juaj që pretendimi ynë të merret i bazuar dhe të obligohet AK të largojë këtë kriter diskriminues nga dosja e tenderit, duke mundësuar pjesëmarrje të barabartë dhe konkurrencë reale ndërmjet operatorëve ekonomikë.

• **Prendimi 3: Në Kërkesën 12 është kërkuar si në vijim: Së paku një (1) shtrues pllakash me përvojë dhe certifikim**

Sa i përket kërkesës për së paku një (1)shtrues pllakash me përvojë dhe certifikim, konsiderojmë se kërkesa për certifikim formal është e panevojshme dhe në kundërshtim me natyrën praktike të këtij profesioni. Shtrimi i pllakave është zanat praktik që në tregun vendor realizohet kryesisht mbi bazën e përvojës profesionale dhe jo mbi posedimin e certifikatave formale. Autoriteti Kontraktues nuk ka paraqitur asnjë dispozitë ligjore, standard profesional apo kërkesë teknike të detyrueshme që e bën certifikimin kusht për realizimin e këtyre punimeve. Arsyetimet e dhëna nga AK lidhur me cilësinë e punimeve dhe shmangien e defekteve janë vetëm përshkrime të përgjithshme dhe nuk dëshmojnë domosdoshmërinë e certifikimit formal. Përvoja praktike e personelit përbën dëshmi të mjaftueshme për aftësinë profesionale në realizimin korrekt të punimeve.Kërkesa për certifikim paraqet kufizim të panevojshëm të konkurrencës dhe krijon favorizim për operatorë të caktuar ekonomik, në kundërshtim me parimet e proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit në prokurimin publik. Andaj, kërkojmë nga ana juaj që pretendimi ynë të merret i bazuar dhe të obligohet AK të largojë këtë kriter diskriminues nga dosja e tenderit, duke mundësuar pjesëmarrje të barabartë dhe konkurrencë reale ndërmjet operatorëve ekonomikë.

- **Prendimi 4: Në Kërkesën 13 është kërkuar si në vijim:**

Makineri për prerjen dhe gryerjen e asfaltit, min. 40 Ton

Ky kriter paraqet një kërkesë të pajustificueshme, joproporcionale dhe tej mase specifike në raport me natyrën, vëllimin dhe kompleksitetin e punimeve të parapara në këtë aktivitet të prokurimit. Kërkesa për posedimin e një makinerie për prerjen dhe gryerjen e asfaltit me kapacitet minimal prej 40 Ton nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe kufizon drejtpërdrejt konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë, duke pamundësuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që posedojnë kapacitete të mjaftueshme profesionale dhe teknike për realizimin e kontratës, por që nuk disponojnë pajisje me këtë tonazh specifik. Nga analiza e tregut dhe informacionet e disponueshme rezulton se pajisje të tilla janë jashtëzakonisht të kufizuara në tregun vendor, madje sipas informatave dhe dëshmimeve që posedojmë, ekziston vetëm një pajisje e tillë në vend. Kjo situatë krijon dyshime të bazuara se kriteri është përshtatur për operator të caktuar ekonomikë dhe jo në funksion të nevojave reale të projektit, duke cenuar parimet e trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe konkurrencës së lirë të garantuara me Ligjin për Prokurimin Publik. Po ashtu, vlen të theksohet se gjatë kësaj periudhe nga vet Autoriteti Kontraktues janë zhvilluar së paku nëntë (9) procedura të prokurimit me objekt punime asfaltimi, mirëpo në asnjërën prej tyre nuk është kërkuar makineri për prerjen dhe gryerjen e asfaltit me kapacitet minimal prej 40 Ton. Për më tepër, edhe në projekte shumë më të mëdha infrastrukturore në vend, përfshirë asfaltimin e rrugëve Nacionale dhe Autostradave, nuk janë vendosur kriteret të tilla specifike për këtë pajisje. Kjo dëshmon qartë se kërkesa nuk është standard teknik i domosdoshëm për realizimin e punimeve, por një kriter i vendosur në mënyrë selektive dhe jo të arsyetuar. Në këtë rast konkret, aktiviteti i prokurimit ka të bëjë me ndërtimin e një salle sportive dhe natyra e punimeve nuk parasheh nevojë reale për përdorimin e një makinerie me tonazh minimal prej 40 Ton. Punimet e prerjes, gryerjes dhe largimit të asfaltit apo dheut mund të realizohen në mënyrë të rregullt dhe efikase edhe me pajisje tjera me kapacitet dukshëm më të ulët, përfshirë pajisje me peshë deri në 10 Ton apo edhe me eskavatorë standardë ndërtimorë. Ne posedojmë përvojë konkrete në realizimin e punimeve të ngjashme në terene të njëjta, ku përfshihen gryerjen dhe largimin e asfaltit dhe dheut, ku këto punime janë realizuar pa asnjë problem teknik përmes pajisjeve alternative adekuate. Rrjedhimisht, kërkesa për makineri me kapacitet minimal prej 40 Ton nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë dhe proporcionale me nevojat reale të kontratës dhe si e tillë paraqet kriter diskriminues dhe kufizues për konkurrencën, në kundërshtim me parimet themelore të prokurimit publik.

Pavarësisht arsytimit të dhënë nga Autoriteti Kontraktues në refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, konsiderojmë se kërkesa për makineri për prerjen dhe gryerjen e asfaltit me kapacitet minimal prej 40-Ton mbetet e pajustificueshme dhe jo proporcionale me natyrën reale të punimeve të parapara në këtë aktivitet të prokurimit. Autoriteti Kontraktues pretendon se pajisja kërkohet për ndërhyrje të kontrolluara në shtresat ekzistuese asfaltike dhe për ruajtjen apo sanimin e pjesëve të asfaltit, si dhe precizitet për gryerje mirëpo një arsyetim i tillë nuk mbështetet në paramasën dhe paralogarinë e publikuar pasi që në bazë paramasës është specifikuar demolim si dhe gryerja apo më saktësisht pjesa e gryesës nuk është fare e nevojshme pasi që të largohet pjesa e asfaltit aty do të bëhen gjurmime të nevojshme, mbushjeve me zhavor, beton etj si dhe përgatitjet për fazat e tjera të punimeve ndërtimore dhe nuk do të paraqitet nevoja fare për gryerje. Pretendimi i Autoritetit Kontraktues se kapaciteti i pajisjes lidhet edhe me efikasitetin, sigurinë, kontrollin e trashësisë së gryerjes dhe aftësinë për realizimin e punimeve brenda afateve të kontratës nuk qëndron dhe nuk është i mbështetur në ndonjë analizë konkrete teknike. Autoriteti Kontraktues nuk ka paraqitur asnjë dëshmi profesionale apo specifikim teknik që dëshmon se vetëm një pajisje me kapacitet minimal prej 40 Ton mund të sigurojë realizimin cilësor të punimeve apo përfundimin e tyre brenda afateve të kontratës. Në bazë të kushteve dhe kërkesave të dërgesës, pika 5.2, është përcaktuar se kontrata fillon në ditën e nënshkrimit dhe përfundon brenda afatit prej dymbëdhjetë (12) muajsh.

Ky afat kohor është më se i mjaftueshëm për realizimin e punimeve edhe përmes përdorimit të pajisjeve ekuivalente me kapacitet më të ulët, të cilat kryejnë të njëjtin funksion teknik në mënyrë të rregullt dhe profesionale.

Rrjedhimisht, pretendimi se vetëm pajisja me tonazh minimal prej 40 Ton garanton realizimin e punimeve brenda afatit kontraktues është i pabazuar. Kohëzgjatja prej 12 muajsh nuk e bën të domosdoshëm përdorimin e një pajisjeje kaq specifike dhe të kufizuar në treg. Punimet e parapara mund të realizohen pa asnjë pengesë teknike edhe me pajisje alternative adekuate, duke respektuar standardet e kërkuara të cilësisë dhe afatet e kontratës.

Në vendimet e nxjerra nga Paneli Shqyrtues, konkretisht në lëndët 624/2025 dhe 955/2025, pavarësisht faktit se natyra e punimeve ka qenë asfaltim dhe ndërhyrje në infrastrukturë rrugore, pajisjet e kërkuara për prerje dhe gërryerje të asfaltit me peshë kaq të lartë janë vlerësuar si të panevojshme dhe me peshë të pajustificuar në raport me objektin e kontratës si dhe specifikimi i tillë ka ndikuar në rritje të panevojshme të kriterëve teknike, duke kufizuar konkurrencën, pajisjet e kërkuara nuk janë konsideruar proporcionale me natyrën dhe kompleksitetin e projektit.

Në këtë kontekst, Paneli ka vlerësuar se kërkesa për këto pajisje, edhe pse teknikisht të përdorshme në ndërtim rrugor, nuk është e justifikuar kur punimet janë kryesisht asfaltim standard, dhe për këtë arsye është konstatuar mungesë proporcionaliteti në specifikimet teknike.

Kërkojmë nga ana juaj që të obligohet Autoriteti Kontraktues për largimin e kriterit të cekur, pasi që i njëjti paraqet kriter diskriminues, joproporcional dhe kufizues për konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë. Vendosija e këtij kriteri nuk është e mbështetur në nevojat reale të projektit dhe tejkalon kërkesat minimale të domosdoshme për realizimin e kontratës. Ky që është kriter dëshmohet edhe nga numri i madh i kërkesave për rishqyrtim të paraqitura nga operatorët ekonomikë lidhur me këtë çështje, çka tregon qartë se kriteri ka krijuar kufizim të pajustificueshëm të pjesëmarrjes dhe ka cenuar parimet e trajtimit të barabartë, proporcionalitetit dhe konkurrencës së lirë në procedurën e prokurimit publik.

- **Prendimi 4:Në Kërkesën 13 është kërkuar si në vijim:Mini damper me peshore digjitale, min. 4 Ton**

Paraqet kërkesë të panevojshme dhe jo proporcionale me natyrën e kontratës. Specifikimi që mini damperi duhet të posedojë peshore digjitale nuk ka ndikim real në cilësinë, sigurinë apo realizimin e punimeve të parapara në këtë aktivitet të prokurimit. Funkcionin e njëjtë operacional dhe transportues e kryen edhe mini damperi standard pa peshore digjitale, prandaj ky specifikim përbën vetëm një kufizim të panevojshëm teknik. Peshorja digjitale nuk është element esencial për ekzekutimin e punëve, por vetëm një pajisje shtesë e cila nuk ndikon në performancën bazë të makinerisë. Si rrjedhojë, vendosja e këtij kriteri ngushton konkurrencën dhe favorizon operatorë të caktuar ekonomikë që posedojnë pajisje me këtë karakteristikë specifike, duke përjashtuar padrejtësisht operatorë të tjerë që posedojnë mini damper funksional dhe të përshtatshëm për realizimin e kontratës. Në përputhje me parimet e proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë në prokurim publik, autoriteti kontraktues duhet të kërkojë vetëm pajisje që janë domosdoshmërisht të nevojshme për realizimin e kontratës, e jo specifikime shtesë që nuk kanë ndonjë arsyetim teknik apo funksional. Pavarësisht arsyetimit të dhënë nga Autoriteti Kontraktues në kërkesën për rishqyrtim të refuzuar, konsiderojmë se kërkesa që mini damperi të posedojë peshore digjitale mbetet plotësisht e panevojshme, joproporcionale dhe pa ndonjë arsyetim real teknik apo funksional në raport me natyrën e kontratës. Autoriteti Kontraktues ka dhënë vetëm arsyetime të përgjithshme lidhur me “kontrollin e sasive”, “shmangien e mbingarkesës” dhe “menaxhimin më të saktë të materialeve”, mirëpo këto pretendime nuk dëshmojnë në asnjë mënyrë pse posedimi i peshorës digjitale në mini damper është kusht i domosdoshëm për realizimin e projektit. Kontrolli i sasive të materialeve nuk lidhet me posedimin e një peshoje digjitale në mini damper, pasi matja dhe verifikimi i sasive realizohen përmes paramasës, situacioneve, faturimeve dhe metodave standarde të mbikëqyrjes teknike gjatë ekzekutimit të kontratës. Po ashtu, shmangia e mbingarkesës është çështje e përdorimit korrekt të pajisjes dhe respektimit të kapacitetit të lejuar nga prodhuesi, e jo posedimit të një peshoje digjitale. Autoriteti Kontraktues nuk ka paraqitur asnjë analizë teknike apo profesionale që dëshmon se mini damperi standard, pa peshore digjitale, nuk është i përshtatshëm për realizimin e punimeve të parapara. Funkcioni bazë i mini damperit është transporti dhe bartja e materialeve në kantier, funksion i cili realizohet në mënyrë të njëjtë edhe nga pajisjet standarde pa këtë karakteristikë shtesë. Për rrjedhojë, peshorja digjitale nuk ndikon në cilësinë e punimeve, sigurinë e objektit apo realizimin teknik të kontratës. Kjo kërkesë paraqet vetëm një specifikim shtesë të panevojshëm teknik, i cili eliminon konkurrencën dhe favorizon oe të caktuar që posedojnë pajisje me këtë karakteristikë specifike.

• • **Prendimi 5: Në Kërkesën 13 është kërkuar si në vijim:**

Gjenerator, min. 80 kVA – është kërkesë joproportionale, pasi që funksionaliteti i punimeve mund të realizohet edhe me gjeneratorë me kapacitet më të ulët, varësisht nga nevojat konkrete në teren. Vendorsja e kufirit minimal min.80kVA pa ndonjë arsytim teknik përkatës kufizon pa nevojë pjesëmarrjen e Operatorëve Ekonomikë. Autoriteti Kontraktues nuk ka dëshmuar se kapaciteti minimal prej 80 kVA është domosdoshmëri teknike për këtë projekt konkret. Rrjedhimisht, kriteri tejkalon nevojat reale të kontratës dhe kufizon pa nevojë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë, në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë. Për rrjedhojë, këto kritere bien ndesh me parimet e proporcionalitetit, konkurrencës së lirë dhe trajtimit të barabartë, të parapara me Ligjin për Prokurimin Publik. Andaj, kërkojmë nga ana juaj që pretendimi ynë të merret i bazuar dhe të obligohet AK të largojë këtë kriter diskriminues nga dosja e tenderit, duke mundësuar pjesëmarrje të barabartë dhe konkurrencë reale ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Të gjitha pretendimet tona i bazojmë në përvojën tonë konkrete profesionale dhe në realizimin e kontratave të mëhershme identike të kësaj natyre, të zhvilluara po në kuadër të të njëjtit Autoritet Kontraktues. Gjatë realizimit të këtyre kontratave, asnjëherë nuk është paraqitur nevoja për staf me certifikime të tilla specifike apo për pajisje me karakteristikat dhe kapacitetet e kërkuara në këtë procedurë të prokurimit. Përkundër mungesës së këtyre kërkesave, kontratat janë realizuar me sukses të plotë, brenda afateve kontraktuale dhe pa asnjë vërejtje lidhur me cilësinë, funksionalitetin apo performancën e punimeve gjatë kësaj periudhe pesëvjeçare. Kjo dëshmon qartë se kriteret e vendosura në këtë procedurë nuk janë të domosdoshme për realizimin korrekt të kontratës, por paraqesin kërkesa të tepruara dhe joproportionale që kufizojnë padrejtësisht konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Me këtë veprim AK ka bere shkelje te nenit 1 te LPP-së ku thuhet se: vendimet e AK-ve, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji. Autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Gjithashtu shihet qarte se AK ka bere shkelje te nenit 7 te LPP-së ku ne piken 1 thuhet se : Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Ndërsa në piken 2 thuhet :Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

Besojmë se i kemi elaboruar me shume se sa qe duhet shkeljet e AK-se ne këtë aktivitet te Prokurimit andaj, Kërkojmë nga ana juaj si Organ Shqyrtues i Prokurimit te merret vendimi si ne vijim:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar Ankesa e Operatorit Ekonomik : **“AAB CONSTRUCTION” SH.P.K.**.. ne lidhje me aktivitetin e prokurimit: **Ndertimi i salles sportive ne Peqan** me numër. të prokurimit: **624-26-2748-5-2-1** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna Suharekë.

ANULOHET Njoftimi për Kontratë dhe të ripërpilohen kriteret në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik, duke vendosur kritere që janë të lidhura drejtpërdrejt me natyrën dhe objektin e kontratës.

Në të kundërtën, do të jemi të obliguar që lëndën ta procedojmë për shqyrtim pranë organeve kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Mundesia e konkurimit

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë”

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*